

Banka e Shqipërisë

Publikimi i pasqyrave të statistikave të sektorit të jashtëm sipas M6BP

Qershor 2014

M6BP është botimi i gjashtë i Manualit të Bilancit të Pagesave dhe Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare, i publikuar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN).

FMN publikon rishikime të Manualit në përgjigje të zhvillimeve financiare dhe ekonomike, nevojës së përdoruesve për informacion më analitik dhe përvojës së akumuluar të mbledhësve të statistikave. Më konkretisht, rishikimi i fundit është diktuar prej procesit të zgjerimit të marrëdhënieve mes ekonomive, nxitur nga migracioni dhe proceset globale të prodhimit (globalizimi), prej krijimit dhe zgjerimit të instrumenteve të reja financiare (risitë financiare) dhe prej nevojës për të evidentuar ndikimin e transaksioneve ndërkombëtare në bilancin e subjekteve pjesëmarrëse, duke ofruar konsistencë më të mirë me *Sistemin e Llogarive Kombëtare* dhe me *Statistikat Monetare dhe Financiare*.

M6BP ofron një shkallë të lartë vazhdimësie me standardin e mëparshëm, M5BP. Ndonëse kuadri i përgjithshëm mbetet i njëjtë, M6BP ofron më tepër specifitime dhe sqarime, të cilat ishin identifikuar gjatë zbatimit të M5BP. Gjithashtu, M6BP ofron një lidhje dhe mbështetje më të fuqishme teorike me statistika të tjera makroekonomike.

Duke filluar nga publikimet e muajit qershor 2014, Banka e Shqipërisë (Departamenti i Stabilitetit Financiar dhe i Statistikave), do të publikojë pasqyrat e Bilancit të Pagesave (BP), Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare (PIN), Borxhit të Jashtëm Bruto (BJB) dhe Mjeteve të Rezervës (MR) sipas M6BP.

Përdoruesit e statistikave të sektorit të jashtëm duhet të kenë parasysh që në qershor 2014 do të publikohen të kompiluara sipas M6BP vetëm statistikave të sektorit të jashtëm për T1 2014¹, me frekuencë tremujore, në euro². Për të siguruar një bazë të përshtatshme krahasimi për analiza të ndryshme, duke filluar nga publikimet për T2 2014, Banka e Shqipërisë do të mundësojë kalimin në M6BP edhe të katër tremujorëve të vitit 2013.

Për interpretimin e statistikave, përdoruesit e tyre duhet të kenë parasysh që, në krahasim me M5BP, kalimi në standardin e ri ka këto karakteristika kryesore:

1. Nuk ndryshojnë vlerat e tepricave të llogarisë korrente, llogarisë kapitale, llogarisë financiare, zërave të rezervës dhe të zërit “gabime dhe harresa neto”.

¹ Me përjashtim të statistikave të stokut, për të cilat është e nevojshme të publikohen dy periudha (T4 2013 dhe T1 2014).

² Statistikat e bilancit të pagesave publikohen në euro, duke reflektuar peshën kryesore që zënë marrëdhëniet ekonomike dhe transaksionet e sektorit të jashtëm me vendet e Eurozonës dhe të Bashkimit Evropian. Sipas nevojës, publikuesit e statistikave të sektorit të jashtëm mund të bëjnë konvertimin e vlerave të këtyre statistikave në ALL, USD ose valuta të tjera, duke përdorur kursin mesatar (për flukset) dhe kursin e fundit të periudhës (për stoqet) të publikuar në: (http://www.bankofalbania.org/web/Statistika_230_1.php?evn=agregate_parent_sel&evb=agregate&Cgroups=28&periudha_id=1).

2. Ndryshon përdorimi i “shenjës”, sipas tabelës më poshtë.

	M5BP (ishte)	M6BP (bëhet)
Llogaria korrente dhe kapitale	Transaksionet në kredi paraqiten me shenjë “pozitive” dhe transaksionet në debi paraqiten me shenjë “negative”	Transaksionet në debi dhe në kredi regjistrohen me shenjë “pozitive”
Llogaria financiare	Rritja në mjete dhe ulja në detyrime paraqitet me shenjë “negative”; ulja në mjete dhe rritja në detyrime paraqitet me shenjë “pozitive”	Rritja në mjete dhe në detyrime paraqitet me shenjë “pozitive”; ulja në mjete dhe në detyrime paraqitet me shenjë “negative”
Bilanci i llogarisë financiare	Llogaritet si shumë e mjeteve me detyrimet	Llogaritet si diferencë e mjeteve me detyrimet

3. Për elementët përbërës të bilancit të pagesave, M6BP ofron një version të sintetizuar të klasifikimit që *Standardi i Llogarive Kombëtare* bën për sektorët institucionalë. M6BP i klasifikon llogaritë e sektorit të jashtëm në katër sektorë institucionalë kryesorë:

- a. “bankë qendrore”, që (në M5BP) zëvendëson “autoritete monetare” si sektor institucional (ndonëse “autoritete monetare” mbetet një koncept thelbësor për të përcaktuar mjetet e rezervës);
- b. “korporata depozitë-pranuese me përjashtim të bankës qendrore”, që zëvendëson termin “banka”;
- c. “qeveria e përgjithshme”, e pandryshuar nga M5BP; dhe
- d. “sektorë të tjerë”, detajohet më tej në “korporata të tjera financiare” dhe “korporata jofinanciare, ekonomi shtëpiake dhe institucione jofitimprurëse në shërbim të ekonomive shtëpiake”.

4. Sipas M6BP, në llogarinë korrente:

- a. “Merkantingu (eksporti neto i mallrave nën ndërmjetësimin tregtar)” dhe të tjera shërbime që lidhen me tregtinë, janë riklasifikuar nga “shërbime” tek “mallra”;
- b. “Shërbime për përpunim të inputeve fizike të zotëruara nga të tjerët” (“mallra për përpunim” në M5BP) dhe “shërbime për mirëmbajtje dhe riparime” (“mallra për riparim” në M5BP) janë riklasifikuar nga “mallra” tek “shërbime”;
- c. Termat “të ardhura parësore” dhe “të ardhura dytësore” zëvendësojnë respektivisht termat “të ardhura” dhe “transferta korrente”, duke siguruar në këtë mënyrë konsistencë me *Sistemin e Llogarive Kombëtare 2008*.
- d. Transfertat personale tek “të ardhura dytësore” përfshijnë të ardhurat nga emigrantët³ si një nënkategori. Transfertat personale nuk kufizohen vetëm tek transfertat ndërmjet familjeve dhe të ardhurave nga punësimi, por përfshijnë të gjitha transfertat ndërmjet individëve rezidentë dhe jorezidentë, në para ose forma të tjera.

³ Duke filluar nga tremujori i parë 2014, të ardhurat nga emigrantët do të përlogariten bazuar në vrojtimin mbi dërgesat nga emigrantët, i kryer nga Banka e Shqipërisë, dhe të dhëna për dërgesat e emigrantëve të përcjella në kanalet formale (operatorët e transferimit të parave dhe sistemi bankar).

Shpjegues për ndryshimet në publikimin e statistikave të sektorit të jashtëm sipas BPM6

Llogaria korrente	M5BP (ishte)		M6BP (bëhet)
Mallrat	Mallrat e përgjithshme	→	Mallrat e përgjithshme
	Mallra për përpunim	→	Eksporti neto i mallrave nën ndërmjetësimin tregtar (kredi)
	Mallra për riparim	→	-
	Mallra të blera në porte	→	-
	Ari jo-monetar	→	Ari jo-monetar
Shërbimet	Shërbime transporti	→	Shërbime për përpunim të inpleteve fizike të zotëruara nga të tjerët
	Shërbimet e udhëtimit	→	Shërbime mirëmbajtje dhe riparimi
	Shërbime konstruksioni	→	Transport
	Shërbime sigurimi	→	Udhëtime
	Shërbime financiare	→	Shërbime konstruksioni
	E drejta e autorit dhe licenca	→	Shërbime sigurimi dhe të pensioneve
	Shërbime kompjuteri dhe informacioni	→	Shërbime financiare
	Shërbimet e komunikacionit	→	Pagesa për përdorimin e pasurisë intelektuale
	Ndërmjetësimi tregtar dhe shërbime të lidhura me to	→	Shërbime telekomunikacioni, kompjuteri dhe informacioni
	Shërbime të tjera biznesi	→	Shërbime të tjera biznesi
	Shërbime qeveritare	→	Shërbime dhe mallra qeveritare
	Të ardhura parësore	Të ardhurat	→
Të ardhura dytësore	Transfertat korrente	→	Të ardhura dytësore

5. Sipas M6BP, në llogarinë kapitale dhe financiare:

- a. Mjetet financiare dhe detyrimet e personave që lidhen me ndryshimin e territorit ekonomik të rezidencës (transfertat gjatë migrimit) nuk përfshihen në bilancin e pagesave si transfertat kapitale.
- b. Investimet direkte zërthehen më tej sipas marrëdhënies dhe transaksioneve midis investitorit dhe ndërmarrjes që përfiton investimin, më konkretisht:
 - i. *Investimi nga një investitor direkt në ndërmarrjen e tij të investimit direkt* – ku një subjekt ose grup subjektësh të lidhura është i aftë të ushtrojë kontroll ose një ndikim të rëndësishëm mbi një ndërmarrje të investimit direkt;
 - ii. *Investim i kundërt* – ku një ndërmarrje e investimit direkt jep hua ose zotëron pasuri në investitorin e saj direkt, me kusht që të mos zotërojë 10% ose më shumë të votave në atë investitor direkt;
 - iii. *Investime midis ndërmarrjeve të lidhura* – ku ndërmarrjet janë nën kontrollin ose ndikimin e të njëjtit investitor direkt ose të tërthortë, por këto ndërmarrje nuk kontrollojnë ose ndikojnë mbi njëra-tjetrën.

Kjo paraqitje e investimeve direkte përdoret për të regjistruar mbi baza bruto, mjetet dhe detyrimet e investimit direkt; për shembull, në vend që të paraqitet pozicioni neto i investimeve direkte. Në këtë mënyrë, M6BP është konsistent me Manualin 4 të OECD-së për Investimet e Huaja Direkte.

Shpjegues për ndryshimet në publikimin e statistikave të sektorit të jashtëm sipas BPM6

M5BP (parimi i drejtimit) ⁴	Mln Eur	M6BP (mjete/ detyrime) ⁵	Mln Eur
<i>Investime direkte neto(-29.95+922.99)=893.04</i>	893.05	<i>Investime direkte neto (220.58-1113.63)=-893.05</i>	-893.05
<i>Investime direkte jashtë</i>	-29.95	Investime direkte (Mjetet)	220.58
Kapitali aksioner, neto	-27.42	Kapitali aksioner	125.56
<i>A. Pretendime ndaj ndërmarrjeve të lidhura</i>	-27.5	<i>A. Investitori direkt në ndërmarrjet e investimit direkt</i>	27.5
<i>B. Detyrime ndaj ndërmarrjeve të lidhura (investim i kundërt)</i>	0.07	<i>F. Ndërmarrjet e investimit direkt tek investitori direkt (investim i kundërt)</i>	98.06
C. Fitimi i riinvestuar	-0.12	C. Fitimi i riinvestuar	0.12
Kapitali tjetër, neto	-2.41	Instrumentet e borxhit	94.9
<i>D. Pretendime ndaj ndërmarrjeve të lidhura</i>	-2.42	<i>D. Investitori direkt në ndërmarrjet e investimit direkt</i>	2.42
<i>E. Detyrime ndaj ndërmarrjeve të lidhura (investim i kundërt)</i>	0.02	<i>J. Ndërmarrjet e investimit direkt tek investitori direkt (investim i kundërt)</i>	92.48
Investime direkte në Shqipëri	923	Investime direkte (Detyrime)	1113.63
Kapitali aksioner, neto	860.6	Kapitali aksioner	958.73
<i>F. Pretendime mbi investitorët direktë (investim i kundërt)</i>	-98.06	<i>G. Investitori direkt në ndërmarrjet e investimit direkt</i>	958.66
<i>G. Detyrime ndaj investitorëve direktë</i>	958.66	<i>B. Ndërmarrjet e investimit direkt tek investitori direkt (investim i kundërt)</i>	0.07
H. Fitimi i riinvestuar	57.01	H. Fitimi i riinvestuar	57.01
Kapitali tjetër, neto	5.39	Instrumentet e borxhit	97.89
<i>I. Pretendime mbi investitorët direktë (investim i kundërt)</i>	-92.48	<i>J. Investitori direkt në ndërmarrjet e investimit direkt</i>	97.87
<i>J. Detyrime ndaj investitorëve direktë</i>	97.87	<i>E. Ndërmarrjet e investimit direkt tek investitori direkt (investim i kundërt)</i>	0.02

- c. Sipas M6BP, alokimet e reja të SDR-ve të vendeve pjesëmarrëse në Departamentin e SDR-ve të FMN-së regjistrohen si rritje në mjetet bruto të rezervës (zotërimet e SDR-së) dhe, në të njëjtën kohë, në detyrime afatgjata të borxhit të autoriteteve (alokimet e SDR-së).
- d. M6BP përfshin llogaritë e paalokuara në ar, përveç shufrave të arit, si shtesë në arin monetar dhe mjetet e rezervës.

⁴ Sipas M5BP, komponentët standardë të investimit direkt prezantohen sipas parimit të drejtimit. Për shembull, investimet direkte në Shqipëri (detyrimet në tabelën e PIN) përfshijnë pretendimet dhe detyrimet ndërmjet një ndërmarrjeje të investimit direkt dhe investitorit direkt jo rezident.

⁵ Sipas M6BP, komponentët standardë të investimit direkt prezantohen në mjete/detyrime. Për shembull, investimet direkte në Shqipëri (detyrimet në tabelën e PIN) nuk përfshijnë pretendimet ndërmjet një ndërmarrjeje të investimit direkt dhe investitorit direkt jorezident, të cilat janë, tani, pjesë e investimit direkt jashtë (investim i kundërt/ mjetet në tabelën e PIN).